

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për kualifikimin profesional

ELEKTROTEKNIKË

Niveli IV i KSHK¹, referuar niveli IV në KEK²
(1 vjeçar)

Kodi: E-IV-25

Miratoi:

MINISTRI

1. Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2. Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) 1 vjeçare.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional të kualifikimit profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**
- XI. Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “Elektroteknikë”, Niveli IV në KSHK.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV I KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar si teknik elektrik në veprimtaritë profesionale që lidhen me kualifikimin profesional elektroteknik, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë” niveli IV I KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet e nivelit III të KSHK në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente;
- të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;
- të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij;
- të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërën nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- të hartojë një plan-biznesi që lidhet me veprimtaritë profesionale të drejtimit elektroteknikë;
- të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të drejtimit elektroteknikë;
- të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale të drejtimit elektroteknikë;
- të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin që lidhet me veprimtaritë profesionale të drejtimit elektroteknikë;
- të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale të drejtimit elektroteknikë;
- të zbatojë standardet teknike të profesionit të drejtimit elektroteknikë;
- të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale të drejtimit elektroteknikë;
- të realizojë instalimin elektrik të objekteve tregtare dhe të shërbimit;
- të analizojë karakteristikat e impianteve të energjisë së rinovueshme;
- të shpjegojë llojet e matjeve të parametrave në sistemet elektrike;
- të analizojë skema të ndryshme të elektronikës në impiante të energjive të rinovueshme;
- të kryejë procedurat për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në fushën e elektroteknikës;
- të kryejë procedurat për administrimin dhe menaxhimin e një biznesi elektroteknikë;
- të hartojë një plan marketing-u dhe të zhvillojë marketingun në biznesin elektroteknikë;
- të përdorë programin kompjuterik për të realizuar me kompjuter vizatime të ndryshme që lidhen me profesionin e elektroteknikut;

- të përdorë programet kompjuterike për ndërtimin, ekzekutimin dhe testimin e skemave elektrike;
- të analizojë elementet e një transmisioni elektrik;
- të analizojë skema elektronike me porta logjike dhe mikroprocesorë;
- të analizojë projekte të thjeshta elektrike të objekteve civile dhe industriale;
- të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës;
- të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Elektroteknikë” niveli IV në KSHK, e pajis individin me certifikatën e teknikut elektrik në këtë drejtim.

Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin elektroenergjitik (prodhim, transmetim, shpërndarje), në sektorë të ndryshëm të industrisë, në njësi të shërbimeve elektrike ose firma që realizojnë instalime elektrike të ndryshme, në shërbime të riparimeve e mirëmbajtjes të pajisjeve, si dhe në njësi të tjera ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë në kualifikimin profesional të sistemeve elektronike apo elementeve të tyre përbërës si dhe ato të dimensionimit dhe menaxhimit optimal të tyre. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e instalimeve elektrike të godinave civile dhe reparteve industriale.

Me përfundimin e arsimimit në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli i IV në KSHK, ai/ajo fiton “Maturën shtetërore profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.

III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Elektroteknikë” niveli IV i KSHK.

Plani mësimor për drejtimin “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/16 (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1
9		Histori	1

10		Gjeografi	1
11		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (288)
1	L-17-197-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-24	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-11-567-25	Transmisione dhe rrjeta elektrike	2
4	L-12-568-25	Elektronikë dhe procese automatizimi	2
5	L-26-271-25	Përdorimi i programeve kompjuterike në elektroteknikë	1
6	L-17-272-12	Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (192)
1	M-11-2205-25	Instalimi elektrik i i objekteve tregtare dhe të shërbimit	72
2	M-17-1751-25	Hapja, menaxhimi dhe mbyllja e biznesit në elektroteknikë	30
3	M-17-818-25	Zhvillimi i marketingut në biznesin elektroteknik	30
4	M-26-819-25	Ndërtimi i skemave elektrike me programe kompjuterike	30
5	M-11-1752-25	Projektimi i instalimit elektrik në një banesë	30
		Gjithsej A+B+C	30/31 (960/ 992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale

të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj.

Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit.

Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimit profesional “Elektroteknikë”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MEKI.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional mësimor “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Elektroteknikë”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e teknikut në fushën e elektroteknikës, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sipas modeleve të miratuara nga MEKI, këto dëshmi përmbajnë;

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin profesional e fituar, etj;

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi;

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës

13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-22). Kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve;
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit;
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi;
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit;
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi;
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi;
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi;
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi;
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxheti në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë

Tema 13	Siguracionet personale	3 orë
----------------	------------------------	-------

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, (L-05-198-24). Kl.13 – 32 orë

• Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- Të shpjegojnë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm;
- Të shpjegojnë kuptimin për aftësitë e gjelbra në një ekonomi të gjelbër;
- Të shpjegojnë rëndësinë e aftësive digjitale në përballimin e sfidave globale;
- Të analizojnë mjedisin dhe komponentët e tij;
- Të shpjegojnë ekosistemet dhe biodiversitetin;
- Të analizojnë ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre;
- Të shpjegojë burimet natyrore të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme;
- Të përshkruajë mënyrën e shpjegimit të të dhënave mjedisore;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale;
- Të shpjegojnë kuptimi i cikleve të jetës së produktit dhe krijimi i mbetjeve;
- Të përshkruajnë parimet bazë të ekonomisë qarkulluese;
- Të shpjegojnë proceset dhe teknologjitë e riciklimit;
- Të shpjegojnë dhe japin shembuj nga drejtimit profesionale mbi reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimin.
- Të hulumtojnë mbi platformat digjitale për programet e menaxhimit të mbetjeve
- Të shpjegojnë optimizimin e proceseve të riciklimit duke përdorur teknologjinë
- Të shpjegojnë avantazhet e zgjidhjeve digjitale për mirëmenaxhimin e mbetjeve
- të shpjegojë rëndësinë e ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital të burimeve ujore në drejtimit profesionale përkatëse
- të përshkruajë praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të ujit në fushën profesionale përkatëse.
- të dallojë dhe përdorë sistemet digjitale të monitorimit të përdorimit dhe cilësisë së ujit
- të shpjegojë teknologjitë inteligjente për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit
- të përshkruajë transportin e qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale në drejtimit profesionale përkatëse
- të dallojë opsionet alternative të transportit (p.sh., transporti publik, biçikleta, ecje) si dhe përdorimin e mjeteve elektrike në veprimtari të ndryshme profesionale;
- të dallojë platformat digjitale për transport të qëndrueshëm si dhe Integrimin e teknologjive inovative në sistemet e transportit publik
- të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë mbi konsumin e qëndrueshëm, tregun digjital dhe marketingun digjital
- të dallojë praktikën etike të konsumit, zgjedhjet e konsumatorëve dhe ndikimet e tyre mjedisore
- të shpjegojë praktikën dhe platformën e qëndrueshme të tregtisë elektronike si dhe kuptimin për marketingun digjital për promovimin e produkteve eko-miqësore
- të përshkruajnë modele të qëndrueshme biznesi bazuar në praktikën e ekonomisë së gjelbër dhe digjitale
- të shpjegojë politikat për zhvillim të qëndrueshëm në fusha të ndryshme profesionale
- të shpjegojnë konsideratat etike në qeverisjen digjitale për qëndrueshmëri

Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”

Tema 1	Zhvillimi i qëndrueshëm	3 orë
Tema 2	Bazat e shkencës mjedisore	3 orë
Tema 3	Menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale	6 orë
Tema 4	Ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital i burimeve ujore	4 orë
Tema 5	Transporti i qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale	4 orë
Tema 6	Konsumi i qëndrueshëm, tregu digjital dhe marketingu digjital	4 orë
Tema 7	Sipërmarrja e gjelbër, inovacioni dhe modelet digjitale të biznesit	4 orë
Tema 8	Politika dhe qeverisja për zhvillim të qëndrueshëm	4 orë

3. Lënda “Transmisione dhe rrjeta elektrike” (L-11-567-25), Kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Transmisione dhe rrjeta elektrike”, kl. 13

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Transmisione dhe rrjeta elektrike”, kl.13, nxënësi duhet:

- Të analizojë elementet e një transmisioni elektrik;
 - Të analizojë karakteristikat elektrike të motorëve elektrikë;
 - Të shpjegojë mënyrat e rregullimit të shpejtësisë në transmisionet elektrike;
 - Të përshkruajë lëshimin dhe frenimin në transmisionet elektrike;
 - Të klasifikojë procese të ndryshme industriale
Të analizojë procese të ndryshme industriale;
 - Të vlerësojë mënyrat e ndryshme të kontrollit të proceseve industriale;
 - Të analizojë skemat elektrike dhe ato të automatizuara të furnizimit me energji elektrike;
 - Të analizojë karakteristikat për ndërtimin e rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm elektrik;
 - Të shpjegojë rëndësinë e elementeve të mbrojtjes të sistemeve të furnizimit të pandërprerë me energji elektrike.
 - Të llogarisë rrymën e veprimit të pajisjeve shkyçëse të TU dhe TL;
 - Të përcaktojë seksionin e përcjellësve dhe kabllove në bazë të ngarkesës së lejuar dhe rënies të tensionit.
 - Të analizojë efektet e lidhjes së shkurtër;
 - Të vlerësojë humbjet e fuqisë dhe energjisë në rrjet;
 - Të analizojë mënyrat e rregullimit të tensionit dhe të përmirësimit të faktorit të fuqisë;
 - Të shpjegojë llojet dhe mënyrën e realizimit të tokëzimit, nulifikimit mbrojtës dhe shkarkimeve atmosferike;
 - Të analizojë defektet e mundshme të rrjetit elektrik me dhe pa ngarkesë;
- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Transmisione dhe rrjeta elektrike”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi transmissionet elektrike	7 orë
Tema 2	Karakteristikat elektromekanike të motorëve elektrike	4 orë
Tema 3	Rregullimi i shpejtësisë së transmiseve elektrike	7 orë
Tema 4	Lëshimi dhe frenimi në transmissionet elektrike	5 orë
Tema 5	Analiza e proceseve të ndryshme industriale	7 orë
Tema 6	Impiantet shpërndarës të energjisë elektrike.	7 orë
Tema 7	Llogaritja e parametrave të pajisjeve shkyçëse të TU dhe TL	9 orë
Tema 8	Lidhja e shkurtër	5 orë
Tema 9	Tokëzimi nulifikimi mbrojtës dhe mbrojtja nga shkarkimet atmosferike	7 orë
Tema 10	Diagnostikimi rrjetit elektrik me dhe pa ngarkesë	6 orë

4. Lënda “Elektronikë dhe procese automatizimi” (L-12-568-25), Kl. 13- 64 orë

- Synimet e lëndës “Elektronikë dhe procese automatizimi”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Elektronikë dhe procese automatizimi”, kl.13, nxënësi duhet:

- Të analizojë nivelet e tensionit për sinjale të portave logjike;
- Të përshkruajë llojet e shndërruesve statik.
- Të përshkruajë skemat e kontrollit numerik me logjikë të programueshme
- Të përshkruajë sistemin me mikroprocesorë.
- Të analizojë skema me mikroprocesorë
- Të shpjegojë llojet e matjeve të parametrave në sisteme elektrike
- Të klasifikojë llojet e aparateve dhe instrumentave matëse për sistemet e kontrollit;
- Të përshkruajë llojet e e aparateve dhe instrumentave matëse si dhe mënyrat e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e leximit të manualeve të aparateve dhe instrumentave matëse.
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të procesit të matjeve.
- Të përshkruajë mënyrat e matjes së temperaturës së kontakteve.
- Të analizojë sistemet matëse në distance.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elektronikë dhe procese automatizimi”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Nivelet e tensionit për sinjale të portave logjike	6 orë
Tema 2	Njohuri mbi shndërruesit statik	8 orë
Tema 3	Skemat e kontrollit numerik me logjikë të programueshme	8 orë

Tema 4	Automatizimi i proceseve industriale me mikroprocesor dhe PLC	10 orë
Tema 5	Aplikimi i elektronikës në energji të rinovueshme (PV, FV)	6 orë
Tema 6	Matja dhe analizimi i parametrave elektronikë në impiante	6 orë
Tema 7	Skema matëse dhe komandimi në distancë	8 orë
Tema 8	Metodat e matjes elektrike për madhesitë jo elektrike	6 orë
Tema 9	Aparatet dhe instrumentat matëse	6 orë

5. Lënda “Përdorimi i programeve kompjuterike në elektroteknikë” (L-26-271-25), Kl.13 – 32 orë

- Synimet e lëndës “Përdorimi i programeve kompjuterike në elektroteknikë”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përdorimi i programeve kompjuterike në elektroteknikë”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë funksionin dhe përdorimin e programeve të ndryshme kompjuterike në elektroteknikë.
- Të dallojnë programet e licensuara dhe të drejtën e përdorimit.
- Të instalojnë programe të ndryshme kompjuterike në elektroteknikë.
- Të kryejnë vizatime të ndryshme duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike në elektroteknikë.
- Të ndërtojnë skema elektrike me programe të ndryshme kompjuterike.
Të shpjegojnë mënyrën e ekzekutimit dhe testimit të skemave të ndërtuara me programe të ndryshme kompjuterike.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përdorimi i programeve kompjuterike në elektroteknikë”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Programet e licensuara dhe e drejta e përdorimit.	4 orë
Tema 2	Programet kompjuterike në elektroteknikë dhe ndërfaqja me përdoruesin	4 orë
Tema 3	Vizatimi i formave të thjeshta gjeometrike me program kompjuterik.	12 orë
Tema 4	Projektimi i një objekti të thjeshtë me program kompjuterik	6 orë
Tema 5	Printimi dhe paraqitja e vizatimeve në layout	6 orë

6. Lënda “Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë” (L-17-272-12). Kl. 13 – 32 orë

- Synimet e lëndës “Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë si bëhet organizimi i punës në një biznes elektroteknik
- Të shpjegojnë si funksionon menaxhimi i një biznesi elektroteknik
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të shërbimit në një biznes elektroteknik
- Të shpjegojnë mënyrën e organizimit të sektorit të energjisë elektrike dhe rolin e institucioneve të ndryshme.
Të shpjegojnë si bëhet përzgjedhja dhe aplikimi i një projekti në treg.
- Të shpjegojnë proceset dhe funksionet e ndërmarrjes dhe ndërveprimin me klientët dhe tregun.
- Të tregojnë ligjet që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike dhe aktet normative mbi tregun e energjisë elektrike.
- Të shpjegojnë ç’janë standardet IEC (International Electrotechnical Commission) në elektroteknikë.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Llojet dhe format ligjore të bizneseve në fushën e elektroteknikës	2 orë
Tema 2	Organizimi i punës në një biznes elektroteknik	4 orë
Tema 3	Menaxhimi i veprimtarisë së një biznesi elektroteknik	6 orë
Tema 4	Llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të shërbimit në një biznes elektroteknik	6 orë
Tema 5	Organizimi i sektorit të energjisë elektrike, institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen.	2 orë
Tema 6	Përzgjedhja dhe aplikimi i një projekti në tregun e punës.	4 orë
Tema 7	Kuadri ligjor (<i>i punës dhe fiskal</i>) në sektorin e energjisë elektrike. Ligjet dhe aktet normative mbi tregun e energjisë elektrike.	4 orë
Tema 8	Standardet shqiptare dhe IEC (International Electrotechnical Commission) në elektroteknikë.	4 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Instalimi elektrik i objekteve tregtare dhe të shërbimit”

Kualifikimi profesional: Elektroteknikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INSTALIMI ELEKTRIK I OBJEKTEVE TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT	M-11-2205-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të realizuar projektimin dhe instalimin elektrik të objekteve tregtare dhe të shërbimit duke përzgjedhur mundësinë optimale të furnizimit të objektit me energji dhe realizimin sa më të mirë të furnizimit të çdo elementi.	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të kualifikimit profesional “Elektroteknikë”	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi analizon objektet tregtare dhe të shërbimit Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të zbërthejë planimetrinë. - të studiojë planin e vendosjes së pajisjeve. - të përcaktojë llojin e instalimit. - të realizojë instalimin e ndriçimit sipas kërkesës dhe standarteve teknike. - të përzgjedhë materialet sipas kërkesës së klientit dhe standarteve teknike. - të hartojë preventivin për projektin elektrik. - të zbatojë standartet dhe normat ndërkombëtare për instalimet elektrike në objekte tregtare dhe të shërbimit Instrumentat e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli RN 2 Nxënësi instalon impiantin e ndriçimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të analizojë projektin e ndriçimit; - të montojë ndriçuesit sipas kërkesës së porositesit. - të montojë sensoret për ndriçimin.	

- të montojnë çelsat.
- të montojnë reletë e dritës.
- të montojnë kutinë shpërndarëse.
- të lidhë kabllot me ndriçuesit dhe kutinë shpërndarëse.
- të montojnë ndriçuesit e emergjencës.
- të bëjnë kontrollin e lidhjeve dhe korigjimet perkatese.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
- të zbatojnë standartet ndërkombëtare të instalimeve elektrike

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi instalon prizat ushqyese.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë projektin e fuqisë.
- të zgjedhë prizat sipas kërkesës së klientit dhe ti montojnë ato.
- të zgjedhë kutinë shpërndarëse dhe ta montojë atë.
- të bëjë zgjedhjen e përcjellësve/kabllove sipas fuqisë dhe të bëjë lidhjen me prizat dhe kutitë shpërndarëse.
- të bëjë kontrollin e lidhjeve dhe korigjimet përkatëse.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.
- të zbatojnë standartet ndërkombëtare të instalimeve elektrike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi instalon kamerat, sistemin e alarmit dhe sistemin antizjarr.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë objektin për të cilin do të bëhet instalimi i kamerave, sistemit të alarmit dhe sistemit antizjarr;
- të përcaktojë vendet e vendosjes së pajisjeve sipas kërkesës së klientit
- të zgjedhë elementet e sinjalizimit sipas kërkesës së klientit.
- të zgjedhë kabllot dhe materialet e tjera plotësuese

- sipas standarteve.
- të shtrojë, fiksojë dhe lidhë kabllot me rrjetin ushqyes.
- të instalojë panelet kryesore të sistemeve të sinjalizimit.
- të fiksojë elementet në vendet e përcaktuara
- të lidhë elementet e sinjalizimit me kabllot ushqyese.
- të kontrollojë instalimet e kryera e të bëjë provën e tyre.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, gjatë punës.
- të respektojë standardet ndërkombëtare të instalimit të tokëzimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi monton panelin elektrik dhe gjeneratorin UPS.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë vendin e vendosjes së kuadrit kryesor në bazë të projektit dhe standarteve.
- të zgjedhë saktë elementet e kuadrit kryesor sipas kërkesave të projektit.
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten.
- të vendosë dhe fiksojë kuadrin kryesor.
- të lidhë gjeneratorin e përzgjedhur sipas fuqisë së instaluar
- të instalojë UPS.
- të instalojë mbrojtjen.
- të montojë automatët.
- të montojë elementet e mbrojtjes në kuadrin kryesor.
- të montojë elementet e komandimit në kuadër.
- të shtrojë kabllin hyrës.
- të lidhë kabllin hyrës me elementet e skemës.
- të lidhë elementet e kuadrit me rrjetin shpërndarës të brendshëm.
- të kryejë kontrollin përfundimtar të instalimit të kuadrit kryesor.
- të kryejë kontrollin me tension të instalimit.
- të kryejë tokëzimin e kuadrit kryesor.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e mbrojtjes në punë.
- të zbatojë standardet ndërkombëtare të instalimit elektrik të banesave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi instalon rrjetin e tokëzimit të supermarketit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë skemën e montimit të impiantit të tokëzimit;
- të përcaktojë radhën e duhur për instalimin e rrjetit të tokëzimit.
- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e nevojshme.
- të instalojë shiritin e tokëzimit brenda konstruksionit ndërtimor.
- të instalojë rrjetin e tokëzimit jashtë objektit.
- të kryejë matjen e rezistencës së tokëzimit.
- të plotësojë dokumentacionin përkatës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- të zbatojë standartet ndërkombëtare për instalimet elektrike të objekteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në objekte ku bëhen instalime elektrike industriale
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë te jete e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete për instalimet elektrike në një repart industrial.
- Nxënësit duhet të nxiten të marrin pjesë aktive në hartimin e projektit dhe zbatimin praktik të tij.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të synohet më tepër vlerësimi i aftësive për të hartuar një projekt, si dhe vlerësimi i demonstrimit praktik të shprehive të fituara nga ata për të kryer instalimet elektrike industriale.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisë ku kryhen instalime elektrike industriale
 - Mjete, vegla dhe materialet e nevojshme për hartimin e projektit dhe kryerjen e instalimeve elektrike në një repart industrial
 - Materiale të shkruara si skema, rregullore, manuale, udhëzuesat etj.
 - Materiale ilustruese (pankarta, transparente, makete etj.)
 - Manualët e preventivit, fatura.
-

2. Moduli “Hapja, menaxhimi dhe mbyllja e biznesit në elektroteknikë”

Kualifikimi profesional: Elektroteknikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	HAPJA, MENAXHIMI DHE MBYLLJA E BIZNESIT NË ELEKTROTEKNIKË	M-17-1751-25
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer procedurat për hapjen, menaxhimin dhe mbylljen e një biznesi në fushën e elektroteknikës.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të kualifikimit profesional “Elektroteknikë”.	

Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi identifikon procedurat ligjore dhe administrative për hapjen e një biznesi. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të analizojë përparësitë dhe mangësitë e llojeve të ndryshme të ideve të biznesit. - të përzgjedhë idenë e hapjes së biznesit (hapja e një biznesi të ri, blerja e një biznesi ekzistues, etj). - të përzgjedhë llojin e shërbimit që do të ofrojë biznesi i ri - të analizojë kuadrin ligjor lidhur me biznesin elektroteknik. - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në gjykatën e rrethit. - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e tatimeve. - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në drejtorinë e taksave vendore. - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të regjistrimit (QKR). - të analizojë procedurat për regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të licensimit (QKL). Instrumentat e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli
	RN 2	Nxënësi harton planin e biznesit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përcaktojë qartë qëllimet dhe objektivat e biznesit

elektroteknik.

- të përcaktojë saktë misionin e biznesit elektroteknik.
- të bëjë analizën e tregut të shërbimeve elektroteknike.
- të hartojë planin e financimit të biznesit elektroteknik.
- të përcaktojë vendndodhjen e biznesit elektroteknik.
- të hartojë planin -marketing të biznesit elektroteknik.
- të hartojë planin e menaxhimit të biznesit elektroteknik.
- të përcaktojë saktë strukturën organizative të biznesit që do të krijohet.
- të përcaktojë burimet njerëzore të biznesit.
- të përcaktojë ekipin menaxhues dhe stafin drejtues.
- të përcaktojë procedurat e rekrutimit të stafit.
- të vendosë emrin e biznesit social-shëndetësor.
- të përcaktojë elementet përfaqësues të identitetit të biznesit (logo dhe moto e veprimtarisë).
- të bashkëngjitë shtojca të nevojshme të planit të biznesit (artikuj, diagrame, kontrata, informata të detajuara. financiare, patentë, informata të produkteve, listën e çmimeve, broshura, buletin informativ dhe skica teknike).
- të paraqesë dokumentacionin dytësor të biznesit (kopja e kontratës së françizës dhe gjitha dokumentet dytësore të siguruar nga koncesionari, kopja e qirasë së propozuar ose marrëveshja e blerjes për ndërtimin e hapësirës, kopje e licencës apo dokumenteve tjera ligjore, kopje e C.V. së stafit drejtues, etj).
- të hartojë deklaratën e qëllimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi hap biznesin

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të simulojë regjistrimin e biznesit në gjykatën e rrethit
- të simulojë regjistrimin e biznesit në drejtorinë e tatimeve.
- të simulojë regjistrimin e biznesit në drejtorinë e taksave vendore
- të simulojë regjistrimin e biznesit në qendrën kombëtare të biznesit (QKB)
- të regjistrojë i biznesit në qendrën kombëtare të licensimit (QKL)
- të hartojë rregulloren e brendshme të biznesit
- të simulojë rekrutimin e stafit dhe punonjësve
- të promovojë biznesin e ri
- të hapë dyert për komunitetin që të vizitojë qendrën dhe të informohet për të gjitha çështjet që iu interesojnë.
- të komunikojnë me klientët e interesuar për shërbimet e qendrës të lidhin dhe nënshkruajnë kontrata.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi menaxhon veprimtarinë në një biznes elektroteknik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë parimet bazë të menaxhimit të një biznesi të vogël.
- të bëjë planifikimin dhe hartimin e grafikut të shpërndarjes kohore të punës.
- të mbikqyrë zbatimin e orarit të punës nga punonjësit
 - të përpilojë listë-prezencën e punonjësve.
- të rishpërndarjë punën në rast mungese të punonjësve për të siguruar vazhdimësinë e punës në biznes.
- të mbikqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- të mbikqyrë veprimtaritë e punës së punonjësve.
- të mbajë shënime për performancën e punonjësve dhe të bëjë motivimin e tyre.
- të kujdeset për sigurimin e kushteve të mira të punës në një biznes elektroteknik.
- të marrë masa për zhvillimin profesional të punonjësve.
- të ndërmjetësojë midis punonjësve dhe stafit drejtues për probleme të ndryshme që mund të dalin.
- të marrë masa për zhvillimin e imazhit të biznesit.
- të krijojë kushtet e duhura për modernizimin e biznesit elektroteknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi mbyll biznesin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë vendimin për mbylljen e biznesit duke e argumentuar atë.
- të llogaritë kostot dhe shpenzimet e procesit të mbylljes së biznesit.
- të bëjë njoftimin zyrtar administrativ për vendimin për mbylljen e biznesit.
- të bëjë anulimin e lejes, licencës dhe emrit të biznesit.
- të paguajë taksat dhe borxhet.
- të njoftojë kreditorët për mbylljen e biznesit.
- të njoftojë furnitorët për mbylljen e biznesit.
- të njoftojë sigurimet shoqërore për mbylljen e biznesit.
- të njoftojë partnerët dhe bashkëpunëtorët për mbylljen e biznesit.
- të njoftojë qiradhënësin për mbylljen e biznesit sipas

kushteve të kontratës.

- të njoftojë stafin dhe punonjësit për mbylljen e biznesit jo më vonë se dy javë përpara.
- të njoftojë klientët për mbylljen e biznesit.
- të kryejë procedurat për mbylljen e llogarive bankare të biznesit dhe anulimin e kartave të kreditit.
- të përmbushë shërbimet dhe detyrimet sipas kontratave të lidhura si edhe mbylljen e projekteve.
- të kthejë çdo depozitë apo pagesë për shërbime që nuk janë ofruar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në një biznes që ofron punime apo shërbime elektroteknike.
- Mësuesi dhe specialisti i biznesit duhet të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur nxënësin në procedurat e përditshme konkrete të biznesit.
- Mësuesi dhe specialisti përkatës i biznesit duhet të krijojnë kushtet e përshtatshme për nxënësit në mënyrë që ata të simulojnë të gjitha procedurat e hapjes dhe mbylljes së një biznesi në fushën e shërbimeve elektroteknike.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për të njohur legjislacionin në fuqi mbi të cilin ngrihet biznesi elektroteknik dhe të gjitha procedurat për hapjen dhe mbylljen e një biznesi në fushën e shërbimeve elektroteknike.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset që ofrojnë punime apo shërbime

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen kontaktet me bizneset që ofrojnë punime apo shërbime në fushën e elektroteknikës. Këshillohet që orët e praktikës profesionale të realizohen konkretisht në bizneset që ofrojnë punime apo shërbime në fushën e elektroteknikës ku nxënësit do të ndiqen nga mësuesi në bashkëpunim me specialistin /personin e kontaktit në biznes .
 - Materialet ndihmëse, kartela, regjistra, formularë etj.
 - Udhëzues, katalogë, rregullore, etj.
-

3. Moduli “Zhvillimi i marketingut në biznesin elektroteknik”

Kualifikimi profesional: Elektroteknikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ZHVILLIMI I MARKETINGUT NË BIZNESIN ELEKTROTEKNIK	M-17-818-25
Qëllimi i modulit	Ky modul i aftëson nxënësit për të qënë të aftë të praktikojnë zhvillimin e marketingut në një biznes elektroteknik	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga kualifikimet e nivelit III të KSHK, të kualifikimit profesional “Elektroteknik”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi harton përmbledhjen ekzekutive të planit marketing. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të pasqyrojë qartë objektivat e biznesit - të pasqyrojë qartë strategjitë që ndiqen - të pasqyrojë saktë parashikimet për shitjet - të pasqyrojë tregjet aktuale - të pasqyrojë saktë analizat financiare. Instrumentat e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli
	RN 2	Nxënësi analizon biznesin aktual në fushën e elektroteknikës Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të analizojë bizneset që ofrojnë punime/shërbime elektroteknike. - të analizojë pikat kyçe të konkurrencës. - të analizojë ofruesit e punimeve /shërbimeve elektroteknike. - të analizojë mjedisin ligjor përkatës. - të analizojë grupet e synuara për të qënë klientë të biznesit elektroteknik. - të përcaktojë saktë vendin që zë kjo sipërmarrje në tregun e biznesit elektroteknik. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi bën analizën e tregjeve të synuara

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë me kujdes shërbimet që ofron biznesi i ri
- të përcaktojë qartë objektivat për secilin prej klientëve
- të bëjë përshkrimin demografik të grupeve të synuara për klientë duke u përqëndruar te karakteristikat specifike të tyre
- të përcaktojë tendencat sociale që mund të ndikojnë te klientët
- të përcaktojë gupet e synuara nga pikëpamja e nevojave që kanë duke u përqëndruar në atë çfarë klientët duan dhe në përfitimet përkatëse që marrin nga shërbimi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi harton strategjinë marketing

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pozicionojë qartë produktin në lidhje me konkurentët dhe në sytë e klientëve.
- të përshkruajë strategjitë e përgjithshme të cilat do të përdoren për të shpalosur objektivat dhe misionin e biznesit.
- të përshkruajë marketingun mix të produkteve, duke përfshirë programet marketing specifik (4P).
- të bëjë vlerësimin paraprak të hedhjes në treg të produkteve.
- të përcaktojë strategjinë e çmimeve për çdo produkt.
- të përcaktojë veprimtaritë promociionale për promovimin e biznesit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi harton planin marketing

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë një plan-veprimi të përditshëm për ndjekjen e realizimit të planit marketing.
- të identifikojë në kohë pengesat e mundshme në arritjen e qëllimeve.
- të ndjekë përditë realizimin e planit marketing.
- të kryejë marketingun nëpërmjet internetit.
- të kujdeset për ruajtjen e imazhit të biznesit elektroteknik.
- të promovojë biznesin elektroteknik nëpërmjet veprimtarive të planifikuara në planin marketing
- të mbajë kontakte të vazhdueshme me tregun elektroteknik

-
- të bëjë orientimin dhe motivimin e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve
 - të publikojë dhe reklamojë biznesin në sistemin kombëtar dhe ndërkombëtar elektroteknik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul mund të zbatohet në klasë ose pranë ndonjë biznesi që ofron punime/shërbime elektroteknike.
- Mësuesi ose specialisti i biznesit demonstroi hartimin e një plani marketing për një biznes të dhënë elektroteknik.
- Nxënësit duhet të aktivizohen në situara konkrete ku duhet të hartojnë vetë një plan marketing për një biznes të dhënë elektroteknik.
- Mësuesi ose specialisti përkatës i biznesit vlerësojnë nxënësit për hartimin e një plani marketing të plotë dhe të përshtatshëm.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
 - Klasa ose mjedisë të një biznesi elektroteknik.
 - Mundësimi i vënies në dispozicion të nxënësve i dokumentacionit dhe informacionit të duhur të biznesit për të hartuar planin marketing
 - Formate të gatshme të strukturës së një plani marketing
 - Mjete kancelarie etj.
-

4. Moduli “Ndërtimi i skemave elektrike me programe kompjuterike”

Kualifikimi profesional: Elektroteknikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	NDËRTIMI I SKEMAVE ELEKTRIKE ME PROGRAME KOMPJUTERIKE	M-26-819-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të realizuar vizatime duke përdorur programe kompjuterike si edhe për të ndërtuar skema të ndryshme instalimesh elektrike në kompjuter duke përdorur një nga programet kompjuterike	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga kualifikimet e nivelit III të KSHK, të kualifikimit “Elektroteknikë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Nxënësi realizon vizatime duke përdorur programe kompjuterike Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë një objekt kompleks ose të konceptojë një ide të përshtatshme për një vizatim teknik kompleks. - të analizojë drejt objektin/idenë që do të paraqitet me anë të vizatimit teknik në programin kompjuterik - të përcaktojë parametrat e duhur të vizatimit teknik që do të përgatitet. - të skicojë në letër (me dorë) draftin e vizatimit teknik që do të realizohet me program kompjuterik. - të hapë programin kompjuterik për vizatimin teknik që do të realizohet. - të përgatitë një faqeje të re për vizatimin teknik që do të realizohet - të aplikojë parametrat e kërkuar (formatin, shkallën, etj). - të vendosë saktë koordinatat. - të realizojë vizatimin e objekteve të kërkuara (vijat, rrathët, harqet, elipset, drejtkëndëshat, shumëkëndëshat, figurat komplekse, etj.) - të realizojë vizatimin e shtresave, llojeve dhe trashësive të ndryshme të vijave. - të aplikojë efektet e ndryshme në vizatim. - të realizojë ngjyrosjet dhe hijet e kërkuara.

- të realizojë seksionimet e kërkuara.
- të vendosë përmasat dhe tolerancat e sakta në vizatim.
- të shkruajë tekstet dhe simbolet e kërkuara.
- të editojë vizatimin teknik (selektimet, prerjet, zhvendosjet, kopjimet, ndryshimi i madhësisë, etj.).
- të aplikojë konfigurimet e nevojshme.
- të përgatitë dokumentin për printim.
- të printojë dokumentin.
- të ruajë dokumentin.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN2 Nxënësi vizaton plane të ndryshme, pjesë të projektit elektrik, duke përdorur programin kompjuterik në elektroteknikë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë elementet e duhur që ofron programi kompjuterik për realizimin e një projekti elektrik.
- të analizojë projektin e instalimit të një skeme elektrike të një ndërtesë.
- të përcaktojë radhën e duhur të vizatimit të elementeve.
- të vizatojë elementet e duhur të planit përkatës;
- të përcaktojë pozicionin standard të vendosjes së çdo elementi përbërës të skemës;
- të vendosë siç duhet elementet elektrike në skemë.
- të vendosë dhe lidhë saktë elementet me përcjellësit dhe mes tyre.
- të kontrollojë planet e vizatuara të instalimit;
- të zbatojë standardet e programit kompjuterik për ndërtimin e projektit elektrik;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ndërton skema elektrike duke përdorur programin kompjuterik.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë me kujdes projektin e instalimit të një skeme elektrike në një ndërtesë.
- të analizojë me kujdes elementet përbërës të skemës.
- të përcaktojë radhën e duhur të realizimit të skemës.
- të përzgjedhë drejt elementet përbërës të qarkut elektrik.
- të vendosë siç duhet elementet elektrike në skemë.
- të kryejë etiketimin e linjave dhe komponenteve
- të kontrollojë skemën e ndërtuar
- të zbatojë standardet e programit kompjuterik për ndërtimin e skemave elektrike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.	- Ky modul duhet të trajtohet në klasën ose laboratorin e praktikës së kompjuterëve. - Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të veprimeve në kompjuter për realizimin e vizatimeve teknike dhe ndërtimin e skemave elektrike me programet kompjuterike - Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për përgatitjen, realizimin dhe printimin e vizatimeve teknike, si edhe të ndërtimit të skemave elektrike me programet kompjuterike, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Mësuesi duhet të nxisë nxënësit të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë ose laborator kompjuterash - Kompjutera personalë me programin kompjuterik - Objekte të ndryshme për tu vizatuar. - Skema elektrike për t'u ndërtuar - Printer. - Fomate letrash për vizatime teknike. - Manuale të përdorimit të programeve kompjuterike

5. Moduli “Projektimi i instalimit elektrik në një banesë”

Kualifikimi profesional: Elektroteknikë

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PROJEKTIMI I INSTALIMIT ELEKTRIK NË NJË BANESË	M-11-1752-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të realizuar sipas standarteve e kërkesës së porositesit detyrën e projektimit të një banese si dhe të hartojnë preventivin në përputhje me detyrën e projektimit të një banese. Ky modul ka për qëllim gjithashtu të kultivojë tek nxënësit aftësinë për të punuar në grup, mendimin analitik, aftësi të mira komunikuese, kreativitetin në punë dhe vendimmarrjen	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar njërin nga kualifikimet e nivelit III të KSHK, të kualifikimit profesional “Elektroteknikë”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi bën projektin elektrik të ndriçimit të banesës Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të zbërthejnë planimetrine e banesës. - të llogarisë ngarkesën e banesës sipas kërkesës së klientit dhe standarteve teknike. - të zgjedhë tipin e instalimit sipas kërkesës dhe standarteve teknike. - të përcaktojë vendet për vendosjen e çelsave. - të përcaktojë rrugën e kalimit të përcjellësave. - të vizatojnë skemën e montimit një dhe shumë vijore. - të vizatojnë skemën të ndricimit nga disa pika. - të hartojë preventivin për këtë pjesë të projektit elektrik - të zbatojë stadartet dhe normat ndërkombëtare për instalimet elektrike të banesave. - të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm Instrumentat e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli - Bashkëbisedim profesional RN 2 Nxënësi bën projektin elektrik të fuqisë së banesës. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të vizatojnë skemën funksionale të fuqisë.	

- të zgjedhë tipin e prizave sipas kërkesës dhe standarteve teknike.
- të përcaktojë vendet për vendosjen e prizave
- të përcaktojë rrugën e kalimit të përcjellësave
- të vizatojnë skemën e montimit të prizave të thjeshta.
- të vizatojnë skemën e montimit të prizave me tokëzim, nulifikim.
- të hartojë preventivin për këtë pjesë të projektit elektrik.
- të zbatojë standardet dhe normat ndërkombëtare për instalimet elektrike të banesave
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Bashkëbisedim profesional

RN 3 Nxënësi vizaton instalimin e elementeve të citofonisë dhe videocitofonisë, telefoni, TV.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë drejt objektin dhe skemën e instalimit të citofonit me shume thirrje.
- të vizatojë përcjellsat e elementit të thirrjes, në përputhje me standardet.
- të vizatojë kutinë e elementit të thirrjes.
- të vizatojë drejt lidhjet elektrike të marrësve të citofonisë me shumë thirrje.
- të analizojë drejt objektin dhe skemën e instalimit të telefonisë dhe TV.
- të vizatojë drejt lidhjet elektrike të telefonisë dhe TV
- të respektojë standardet ndërkombëtare të instalimit të citofonit me shume thirrje.
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Bashkëbisedim profesional

RN 4 Nxënësi vizaton instalimin e matësit një fazor

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë kontaktorin në bazë të fuqisë.
- të përcaktojë vendin e montimit të kontaktorit
- të vizatojë lidhjen me përcjellësit të kontaktorit
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë me klientin.

- të zbatojë standartet teknike për instalimin e kontaktorit elektrik
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Bashkëbisedim profesional

RN 5 Nxënësi vizaton instalimin e kuadrit kryesor të banesës

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë vendin e vendosjes së kuadrit kryesor në bazë të projektit dhe standarteve
- të bëjë zgjedhjen e saktë të elementeve kuadrit kryesor sipas kërkesave të projektit
- të vizatojë saktë skemën me elementët e kuadrit kryesor
- të vizatojë lidhjen e kabllit hyrës me elementët e skemës
- të vizatojë lidhjen e elementëve të kuadrit me rrjetin shpërndarës të brendshëm
- të vizatojë tokëzimin e kuadrit kryesor
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë me klientin
- të zbatojë standartet ndërkombëtare të instalimit elektrik të banesave

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 6 Nxënësi instalon rrjetin e tokëzimit të banesës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë skemën funksionale të tokëzimit.
- të analizojë skemën e montimit.
- të përcaktojë radhën e duhur për instalimin e rrjetit të tokëzimit.
- të përzgjedhë drejt veglat dhe materialet e nevojshme.
- të hartojë preventivin për materiale.
- të instalojë shiritin e tokëzimit brenda konstruksionit ndërtimor.
- të instalojë rrjetin e tokëzimit jashtë objektit.
- të kontrollojë rezistencën e tokëzimit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.
- të zbatojë standartet ndërkombëtare për instalimet elektrike të objekteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Bashkëbisedim profesional

**Udhëzime për
zbatimin e modulit
dhe për vlerësimin
e nxënësve.**

- Ky modul duhet të trajtohet në laborator dhe në mjedisin ku do të kryhen instalimet elektrike.
- Rekomandohet që të bëhen vizita në banesa ku bëhen instalime elektrike
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete për instalimet elektrike në një banesë.
- Nxënësit duhet të nxiten të marrin pjesë aktive në hartimin e projektit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të synohet më tepër vlerësimi i aftësive për të hartuar një projekt, si dhe vlerësimi i demonstrimit praktik të shprehive të fituara nga ata për të kryer instalimet elektrike të një banese.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedisë (banesa) ku kryhen instalime elektrike
 - Mjete, vegla dhe materialet e nevojshme për hartimin e projektit të instalimeve elektrike në një banesë
 - Materiale të shkruara si skema, rregullore, manuale, udhezues, etj..
 - Materiale ilustruese (pankarta, makete, projekte të gatshëm etj.)
 - Manualet e preventivit, fatura.
-

XI. Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional "Elektroteknikë", Niveli IV në KSHK.

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional **"Elektroteknikë", Niveli IV në KSHK** përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë nivel kualifikimi, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t'i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional **"Elektroteknikë", Niveli IV në KSHK** është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit,

detyrat e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të realizojë instalimin elektrik të objekteve tregtare dhe të shërbimit .	Instalimi elektrik i objekteve tregtare dhe të shërbimit -Realizimi i proceseve të futjes së përcjellësve në tubo ose kanalina, lidhjes së përcjellësve me njëri-tjetrin dhe elementët e tjerë të instalimit elektrik sipas planimeve përkatëse të projektit të dhënë duke realizuar: -Instalimin e ndriçimit të objektit.	30

		-Instalimin e fuqisë së objektit -Instalimin e rrjeteve DATA, ÇTV, MKZ. -Instalimin e tokëzimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike. -Instalimin e kuadrit elektrik kryesor (KEK), montimin e elementeve dhe lidhjen e tyre me linjat dalëse sipas projektit të dhënë. -Realizimin e instalimit të furnizimit me energji të objektit. -Realizimi i kontrollit të instalimit të kryer, kryerja e matjeve të nevojshme dhe protokollimi i tyre. - Hartimin e preventivit dhe përhgatitjen e faturës.	
2	Të realizojë projektimin e instalimit elektrik të një banese	Projektimi i instalimit elektrik të një banese. Projektimi i planit të ndriçimit të një banese. - Projektimi i planit të fuqisë të banesës - Projektimi i planit të rrjeteve DATA, ÇTV, MKZ. - Projektimi i planit të tokëzimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike. -Ndërtimi i skemës së furnizimit të kuadrit elektrik kryesor (KEK) të objektit. -Kryerja e llogaritjeve të thjeshta tekniko- ekonomike për përzgjedhjen e elementëve të ndryshëm të instalimit. (Vizatimi i projektit të realizohet me anë të një prej programeve -CAD në varësi të kushteve të shkollës.)	40
3	Të hartojë një plan-biznesi që lidhet me veprimtari profesionale të kualifikimit elektroteknik	3 – Hartimi i një plan biznesi (hartimi i objektivave dhe misionit të biznesit). -Përpilimi i strukturës organizative të biznesit që do të krijohet; vendosja e emrit të biznesit dhe hartimi i elementeve përfaqësuese të identitetit të “sipërmarrjes” (logo dhe moto e veprimtarisë së biznesit).	30

		- Përpilimi i një plani financiar i cili parashikon të ardhurat dhe kostot për vitin e parë të aktivitetit të biznesit -Studimi i tregut aktual të ofruesve të punimeve/shërbimeve elektroteknike. -Analiza e klientëve të mundshëm në këtë profil biznesi. -Hartimi i një strategjie specifike promovimi dhe zhvillimi të biznesit.	
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 – 40	4
41 – 50	5
51 – 60	6
61 – 70	7
71 – 80	8
81 – 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “*poste pune*”, grupe pune ose individuale në mjediset e punës së shkollës, kompani etj.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në çdo detyrë është shumë e domosdoshme **respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, duhet të jenë të përfshira domosdoshmërisht në vlerësim.**
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe **bashkëbisedimit profesional** ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.

- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit, me përjashtim të postit të punës, ku shkalla e rrezikshmërisë është relativisht e lartë.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.
- Meqenëse koha për realizimin e detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë nxënësi realizon vetëm njërën nga detyrat.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 1**. Instalimi elektrik i objekteve tregtare dhe të shërbimit

Për realizimin e kësaj detyre, nevojitet që nxënësve t'i vihen në dispozicion mjediset e punës, kryesisht poste pune në laborator (ose objekt në kompani private), instrumente matëse, vegla pune si pinca të ndryshme, kaçavida të ndryshme, indikator, prerëse tubi, prerëse kabulli, etj. Materiale të ndryshme si: tubo të diametrave të ndryshëm, kanalina të përmasave të ndryshme, kuti shpërndarëse ose lidhje, kuti brenda/jashtë murit dy ose tre M, kuti automatësh, përcjellës të seksioneve të ndryshme me ngjyra sipas standardeve, çelësa të tipeve të ndryshëm, priza fuqie dhe rrjeti, automatë, sensorë, kamera, aksesore ndihmës si dhe mjetet e nevojshme për realizimin e punimeve.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete për realizimin e instalimeve elektrike të objektit në fillim kryejnë ballafaqimin e projektit të dhënë me objektin përkatës dhe kryejnë:

-Procesin e futjes së përcjellësve në tuba ose kanalina, lidhjes së përcjellësve me njëri tjetrin dhe elementët e tjerë të instalimit elektrik sipas planimetrisë së dhënë të projektit (planin e instalimit të ndriçimit të brendshëm dhe jashtëm

- Instalimin e sistemit të ndriçimit të objektit

-Instalimin e sistemit të fuqisë së objektit

-Instalimin e sistemit të rrjeteve DATA, ÇTV, MKZ.

-Instalimin e sistemit të tokëzimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike).

-Instalimin e kuadrit elektrik kryesor, montimin e elementeve dhe lidhjen e tyre me linjat dalëse sipas projektit të dhënë.

-Instalimin e furnizimit me energji të objektit.

-Kontrollin e instalimit të kryer, kryerjen e matjeve të nevojshme dhe protokollimin e tyre.

Nxënësi duhet të kryejë procedurat e listuara më sipër nëpërmjet një bashkëbisedimi profesional dhe gjatë këtij procesi mbikëqyret nga komisioni, i cili më pas mund t'i drejtojë pyetje të parapërgatitura për pikat kyçe të procesit

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike, të përdorimit të programeve kompjuterike, manualeve, katalogëve.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale, të tilla si zbatimi i rregullave të komunikimit, respektimi i parimeve të punës në grup etj. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë edhe një listë kriteresh vlerësimi me tolerancën përkatëse për cilësinë e shërbimit.

Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë edhe një listë kriteresh vlerësimi me tolerancën përkatëse për cilësinë e shërbimit.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 2**. Projektimi i instalimit elektrik të një banese.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t'u sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:

Mjedis pune në shkollë ose në kompani private, kompjuter, manuale, katalogë etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete, për realizimin e projektit të instalimit elektrik të një banese në fillim kryejnë analizën e objektit, ku informohen për funksionet, përmasat dhe kërkesat e klientit.

Në bazë të informacionit të marrë nxënësit realizojnë duke përdorur një nga programet kompjuterike të projektimit që shkolla disponon:

- Planin e instalimit të ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm
- Planin e instalimit të fuqisë së objektit
- Planin e instalimit të rrjeteve DATA, ÇTV, MKZ.
- Planin e instalimit të tokëzimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.
- Ndërtimin e skemës së furnizimit dhe kuadrit elektrik kryesor (KEK) të objektit.
- Kryerjen e llogaritjeve të thjeshta tekniko ekonomike për përzgjedhjen e elementëve të ndryshëm të projektit të instalimit.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike, të përdorimit të programeve kompjuterike, manualeve, katalogëve.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale, të tilla si zbatimi i rregullave të komunikimit, respektimi i parimeve të punës në grup etj. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 2** “Projektimi i instalimit elektrik të një objekti.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t'u sigurohen mjediset, mjetet dhe materialet e mëposhtme:

Mjedis pune në shkollë ose në kompani private, kompjuter, manuale, katalogë etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete, për realizimin e projektit të instalimit elektrik të një banese/supermarketi në fillim kryejnë analizën e banesës/supermarketit, ku informohen për funksionet, përmasat dhe kërkesat e klientit.

Në bazë të informacionit të marrë nxënësit realizojnë duke përdorur një nga programet kompjuterike të projektimit që shkolla disponon:

- Planin e instalimit të ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm
- Planin e instalimit të fuqisë së objektit
- Planin e instalimit të rrjeteve DATA, ÇTV, MKZ.
- Planin e instalimit të tokëzimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.
- Ndërtimin e skemës së furnizimit dhe kuadrit elektrik kryesor (KEK) të objektit.
- Kryerjen e llogaritjeve të thjeshta tekniko ekonomike për përzgjedhjen e elementëve të ndryshëm të projektit të instalimit.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike, të përdorimit të programeve kompjuterike, manualeve, katalogëve.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli, e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale, të tilla si zbatimi i rregullave të komunikimit, respektimi i parimeve të punës në grup etj. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Udhëzime për realizimin e **detyrës 3**: “Të hartojë një plan-biznesi”

Për realizimin e kësaj detyre, nevojitet që nxënësve t'i vihen në dispozicion instrumente ndihmëse, kartela, regjistra, formularë , udhëzues, katalogë, rregullore, etj. Gjithashtu është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasa ose mjedise të një biznesi elektroteknik.
- Mundësimi i vënies në dispozicion të nxënësve i dokumentacionit dhe informacionit të duhur të biznesit për të hartuar planin e biznesit
- Formate të gatshme të strukturës së një plani biznesi .
- Mjete kancelarie etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete për realizimin e procedurave të hapjes, zhvillimit dhe mbylljes së një biznesi në fushën e shërbimeve elektroteknike në fillim kryejnë:

- Identifikimin e procedurave ligjore dhe administrative për hapjen e një biznesi , i cili realizohet duke analizuar idetë e biznesit, përzgjedhjen e tij si dhe regjistrimin e tij në institucionet përkatëse.

-Hartimin e planit të biznesit, i cili realizohet duke përcaktuar qartë qëllimet, objektivat dhe misionin e biznesit. Kjo arrihet duke përcaktuar saktë strukturën organizative të biznesit së bashku me burimet njerëzore përkatëse si dhe të përcaktimin e elementëve përfaqësues të identitetit të biznesit (logo dhe moto e veprimtarisë).

-Menaxhimin e veprimtarisë në një biznes elektroteknikë dhe zhvillimin e planit të biznesit të tij duke zbatuar parimet bazë të menaxhimit, zhvillimin profesional të punonjësve si dhe realizimin e marketingut në mënyrë efikase.

-Hartimin e një plani financiar i cili parashikon të ardhurat dhe shpenzimet për vitin e parë të aktivitetit financiar.

-Zhvillimin e një plani strategjik marketingu i cili përfshin analizën e katër P-ve të Marketingut.

-Mbylljen e biznesit të argumentuar, e cila të shoqërohet me të gjitha procedurat përkatëse të saj. Nxënësi duhet të kryejë procedurat e listuara më sipër nëpërmjet një bashkëbisedimi profesional dhe gjatë këtij procesi mbikëqyret nga komisioni, i cili më pas mund t'i drejtojë pyetje të parapërgatitura për pikat kyçe të procesit. Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.